Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 12 shtator 2012

Lënda nr. 13/08

Gani THAÇI

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 12 shtator 2012, në praninë e anëtarëve vijues:

z. Paul LEMMENS, kryesues
znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga:
z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pas konstatimit të tërheqjes së z. Marek Nowicki nga shqyrtimi i lëndës në pajtim me rregullën 12 të Rregullores së punës

Pas konsiderimit të ankesës së lartpërmendur, të parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006,

Pas shqyrtimit, duke përfshirë edhe shqyrtimin përmes mjeteve elektronike, në përputhje me rregullën 13 § 2 të Rregullores së tij të punës, jep konkludimet dhe rekomandimet vijuese:

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa është parashtruar më 2 qershor 2008 dhe është regjistruar në të njëjtën datë. Më 17 qershor 2008, ankuesi zgjeroi ankesën e vet.

2. Më 9 shtator 2010, Paneli shpalli të papranueshme një pjesë të ankesës. Po ashtu, vendoi që të shtyjë shqyrtimin e pjesës tjetër të ankesës.

3. Më 10 qershor 2011, Paneli shpalli të pranueshme pjesën e mbetur të ankesës.

4. Më 19 gusht 2011, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) parashtroi komentet e UNMIK-ut për bazueshmërinë e ankesës.

II. FAKTET

5. Për sa i përket kësaj faze të procedurës, faktet mund të përmblidhen si në vijim. Për një përshkrim më të hollësishëm të fakteve, Paneli i referohet vendimit të vet të datës 10 qershor 2011 lidhur me pranueshmërinë e ankesës, §§ 10-25.

6. Ankuesi ka qenë ish-komandant i komandës së strehimit në Trupave të Mbrojtjes të Kosovës (TMK). Në vitin 2000 ai është degraduar dhe më pastaj është suspenduar në vitin 2001 për shkak të veprave të rënda të mospërputhjes me Kodin disiplinor të TMK-së, posaçërisht për shkak të dhënies së deklaratave të paautorizuara medieve për TMK-në, si dhe për mungesë të paarsyetuar nga puna. Në një datë të paspecifikuar në vitin 2001, ai është shkarkuar nga Komisioni i Përbashkët Ekzekutiv për Siguri (KPES) që atëbotë ishte organi më i lartë për bashkërendim të aspekteve të sigurisë mes UNMIK-ut dhe KFOR-it.

7. Më 28 janar 2005, koordinatori i UNMIK-ut për TMK-në informoi ankuesin se për shkak të parregullsive të caktuara procedurale, PSSP-ja asnjëherë nuk e kishte miratuar vendimin për shkarkimin e tij dhe se, rrjedhimisht, KPES-i do të duhej ta rishqyrtonte këtë rast. Më 8 shkurt 2005, duke iu referuar kësaj letre të koordinatorit të UNMIK-ut për TMK-në, Inspektorati i KFOR-it për çështje të TMK-së ftoi komandantin e TMK-së që të rishqyrtojë lëndën disiplinore.

8. Më 10 shkurt 2005, Zyra ligjore e TMK-së dërgoi një shkresë zëvendëskomandantit të Zonës së dytë mbrojtëse të TMK-së, ku cekeshin akuzat kundër ankuesit. Ankuesi ka marrë këtë informacion më 16 shkurt 2005. Më 17 shkurt 2005 ai parashtroi një deklaratë Zonës së dytë mbrojtëse të TMK-së, ku përfshiheshin komentet për akuzat kundër tij. Kjo deklaratë është dashur t'i dërgohet KPES-it. Nuk është e qartë nëse kjo deklaratë ka mbërri në destinimin e saj. Në bazë të ankuesit, kjo gjë nuk ka ndodhur.

9. Në prill të vitit 2005, KPES-i i rekomandoi PSSP-së shkarkimin e ankuesit për shkak të deklaratave të lartpërmendura të paautorizuara (raporti 685/05). Në një datë të pasaktësuar, PSSP-ja u pajtua me këtë. Panelit nuk i është dhënë kopja e vendimit, por PSSP-ja nuk konteston faktin e marrjes së një vendimi të tillë. Pretendohet se në vendim është theksuar se në përputhje me Kodin disiplinor, përmes komandantit të TMK-së ankuesi do të mund të parashtronte ankesë tek KPES-i brenda 21 ditëve nga dita kur ai ka marrë njoftimin me shkrim për vendimin.

10. Njoftimi është nënshkruar nga shefi i Zyrës ligjore të TMK-së më 24 qershor 2005. Ankuesi ka nënshkruar këtë njoftim më 5 korrik 2005.

11. Sipas ankuesit, më 15 korrik 2005 ai ka parashtruar një ankesë kundër shkarkimit. Ai deklaron se ka dërguar ankesën që përbëhej prej një shkrese (kopjen e së cilës ankuesi ia ka dhënë Panelit) dhe 11 faqe të dokumenteve, zëvendëskomandantit të Zonës së dytë mbrojtëse të TMK-së në Prizren, me kërkesë Shtabi i përgjithshëm i TMK-së të njëjtën t'ia përcjellë KPES-it, i cili ishte autoriteti kompetent për shqyrtimin e saj. Sipas deklaratës së shërbimit postar në Prizren, të datës 25 janar 2006, letra e ankuesit i është dërguar zëvendëskomandantit të Zonës së dytë mbrojtëse të TMK-së më 16 korrik 2005.

12. Duket se ekziston edhe dokumenti, të cilin ankuesi ia kishte dërguar Komisionit të Përbashkët Ekzekutiv për Siguri – KPES në Shtabin e KFOR-it. Sipas deklaratës së shërbimit postar në Prizren, të datës 13 prill 2006, letra e ankuesit është dërguar në Prishtinë më 18 korrik 2005 (kopjen e së cilës ankuesi ia ka dorëzuar Panelit), së bashku me 11 faqet e lartpërmendura të dokumenteve.

13. Ndaj ankesës së ankuesit nuk ka pasur ndonjë reagim. Pasi që ankuesi ishte interesuar për gjendjen e procedurës dhe pasi që kishte kontrolluar në postën e Prizrenit se a ishte dërguar ankesa e tij (shih § 11 më lartë), koordinatori i atëhershëm UNMIK-ut për TMK-në, ia dërgoi atij një letër më 14 mars 2006, ku thuhet si në vijim:

> "I referohem shkresës së paraardhësit tim, të datës 1 nëntor 2005, dhe shkresës së zyrtarit tim ligjor, të datës 19 janar 2006.
>
> Siç është cekur më herët, ankesa juaj ndaj raportit të KPES-it nr. 685/05 nuk është pranuar në zyrën time, në TMK apo në KFOR ose [në Inspektoratin e KFOR-it për çështje të TMK-së]. Sipas Kodit disiplinor, ankesat duhet të bëhen përmes [komandantit të TMK-së] brenda 21 ditëve. Nga ju është kërkuar që ta ridërgoni ankesën tuaj përmes kanaleve të duhura dhe të jepni vërtetimin e dërgesës të ankesës së dërguar paraprakisht, gjë e cila nuk është bërë. Edhe pse keni dërguar vërtetimin e dërgesës të një numri letrash, ju nuk keni dhënë vërtetimin e dërgesës për letrën e datës 18 korrik 2005 që ka të bëjë me ankesën e tanishme.
>
> Pasi që ankesa juaj nuk është pranuar nga [komandanti i TMK-së] ose nga cilado zyrë tjetër përkatëse, dhe nuk mund të vërtetoni se e keni dërguar brenda afatit 21-ditësh për ankesa, me keqardhje ju njoftoj se ky rast tanimë është mbyllur."

14. Më 10 prill 2006, ankuesi ia dërgoi një shkresë zëvendëskomandantit të Zonës së dytë mbrojtëse, përmes së cilës kërkonte nga ai shpjegim se çka kishte bërë me ankesën e tij, të dërguar më 15 korrik 2005 (shih § 11 më lartë). Paneli nuk është në dijeni për çfarëdo reagimi ndaj asaj shkrese.

15. Më 13 korrik 2006 ankuesi është pranuar nga komandanti i TMK-së. Ai e kishte dorëzuar një shkresë, përmes së cilës ankohej për faktin se deklaratën e tij të datës 17 shkurt 2005 dhe ankesën e 15 korrikut 2005 zëvendëskomandati i Zonës së dytë mbrojtëse nuk i kishte dërguar në vendin e duhur. Ai kërkoi ekzaminimin e ankesës së tij. Duket se lidhur me këtë shkresë nuk është ndërmarrë ndonjë veprim.

16. Në ndërkohë, më 29 qershor 2006, ankuesi kishte ngritur një kontest administrativ në Gjykatën Supreme kundër mosveprimit të KPES-it dhe Zonës së dytë mbrojtëse të TMK-së.

17. Më 14 maj 2008, Gjykata Supreme shpalli peticionin e papranueshëm, duke marrë parasysh imunitetin që kanë UNMIK-u dhe KFOR-i. Arsyet për këtë vendim janë si në vijim:

> "Në nenin 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, për Kornizën Kushtetuese mbi vetëqeverisjen e përkohshme në Kosovë, të datës 15 maj 2001, përcaktohet se Trupat e Mbrojtjes së Kosovës (TMK) është organizatë për emergjenca civile, e themeluar sipas ligjit, e cila zbaton në Kosovë detyra të reagimit të shpejtë ndaj fatkeqësive me qëllim të ruajtjes së sigurisë publike gjatë emergjencave dhe të ndihmës humanitare. Në dispozitën e nenit 8.1, pika k të Rregullores së lartpërmendur, parashihet që TMK-ja vepron nën kontrollin dhe autoritetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP).
>
> Neni 3 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/8 për themelimin e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës parasheh që Trupat e Mbrojtjes së Kosovës veprojnë nën autoritetin e PSSP-së.
>
> Neni 30, paragrafi 1, pika 5 i Ligjit për konteste administrative parasheh se kontesti administrativ nuk mund të ngrihet për çështjet, për të cilat mundësia e ngritjes së kontestit administrativ është e përjashtuar sipas dispozitës eksplicite ligjore.
>
> Për shkak të faktit se dispozita 3.2 (*sic*) e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe të pjesëtarëve e punonjësve të tyre në Kosovë parasheh që pjesëtarët e KFOR-it të gëzojnë imunitet para gjykatave të Kosovës përkitazi me çfarëdo vepre administrative, civile apo penale të kryer nga ata në territorin e Kosovës; rrjedhimisht nuk mund të ngitet asnjë kontest administrativ kundër Komisionit të përbashkët ekzekutiv për siguri brenda Shtabit të përgjithshëm të KFOR-it, me seli në Prishtinë dhe kundër Zonës së dytë mbrojtëse të TMK-së, me seli të shtabit në Prishtinë (*sic*).
>
> Për shkak të arsyeve të cekura më lart, dhe në pajtim me nenin 30, paragrafin 2 të [Ligjit për procedurën kontestimore], Gjykata vendosi si në diapozitivin e këtij vendimi."

18. Më 24 qershor 2008, ankuesi ka parashtruar padi penale kundër gjykatësit të Gjykatës Supreme, i cili ka kryesuar panelin gjykues që nxori vendimin e datës 14 maj 2008. Paneli nuk është informuar për çfarëdo zhvillimi të mëtejmë lidhur me ankesën.

III. ANKESA

19. Përkitazi me pjesën e ankesës që është shpallur e papranueshme, fillimisht ankuesi ankohet për faktin se komentet e tij, të datës 17 shkurt 2005, lidhur me akuzat disiplinore të ngritura kundër tij në vitin 2005, nuk janë shqyrtuar në mënyrë të efektshme nga KPES-i para se ta merrte vendimin për dhënien e rekomandimit për shkarkim.

20. Ai më tej ankohet për faktin se ankesa e tij kundër vendimit për shkarkim (ankuesi është njoftuar për vendimin më 5 korrik 2005) në fakt nuk është shqyrtuar asnjëherë nga organi tek i cili ai ka parashtruar ankesën, gjegjësisht nga KPES-i. Ai argumenton se kjo ka ndodhur për shkak të faktit se zëvendëskomandanti i Zonës së dytë të mbrojtjes të TMK-së në Prizren, të cilit ankuesi ia kishte dërguar ankesën më 15 korrik 2005, nuk ia kishte përcjellë atë organit kompetent.

21. Ai në fund ankohet edhe për aktgjykimin e Gjykatës Supreme, të datës 14 maj 2008, përmes të cilit shpallej i papranueshëm kontesti administrativ i ngritur nga ai lidhur me mosveprimin e KPES-it dhe TMK-së ndaj ankesës kundër vendimit për shkarkimin e tij.

22. Siç është cekur në vendimin e Panelit, të datës 10 qershor 2011, ankesa e parë mund të konsiderohet nga pikëpamja e së drejtës në qasje në shërbimet publike, e cila garantohet përmes nenit 25 c) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike (KNDCP), ndërsa ankesa e dytë dhe e tretë mund të konsiderohen nga pikëpamja e së drejtës për mjet të efektshëm ligjor kundër shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njeriut (neni 2 § 3 i KNDCP-së, lidhur me nenin 25 c) të KNDCP-së).

IV. LIGJI

A. Pranueshmëria e ankesës

23. Në komentet e tij për pranueshmërinë e ankesës, PSSP-ja argumentoi se ankesa ishte e papranueshme sepse ishte parashtruar jashtë afatit gjashtëmujor, të paraparë në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut, të datës 23 mars 2006. Për aq sa ishte relevante në atë fazë të procedurës, PSSP-ja ka supozuar se ish-PSSP-ja kishte miratuar rekomandimin për shkarkimin e ankuesit më 5 korrik 2005. Më 14 mars 2006, koordinatori i UNMIK-ut për TMK-në kishte njoftuar ankuesin se ankesa e tij kundër vendimit të PSSP-së fare nuk është pranuar nga KPES-i, dhe se nuk mund të gjendej në asnjërën prej dosjeve. Njoftimi nga ana e koordinatorit të UNMIK-ut për TMK-në mund të konsiderohet si dita e njoftimit përfundimtar të ankuesit për shkarkimin e tij nga TMK-ja. Ankesa është parashtruar në Panel tek më 2 qershor

2008. Sipas PSSP-së, në atë datë, periudha gjashtëmujore për parashtrimin e ankesës në Panel qartazi kishte kaluar.

24. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, Paneli mund të trajtojë çështjen vetëm pasi që të ketë përcaktuar se lënda është parashtruar "brenda periudhës gjashtëmujore nga data e nxjerrjes së vendimit të formës së prerë".

25. Në vendimin e tij për pranueshmëri, të datës 10 qershor 2011, Paneli ka shqyrtuar vërejtjen e ngritur nga PSSP-ja si në vijim:

> "37. Afati gjashtëmujor, i paraparë në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, parasheh që ankuesit t'i parashtrojnë ankesat e tyre brenda gjashtë muajve pas nxjerrjes së vendimit të formës së prerë në kuadër të procesit të shterjes së mjeteve juridike në dispozicion. Për qëllime të llogaritjes së periudhës gjashtëmujore, mund të merren parasysh vetëm mjetet juridike të zakonshme dhe të efektshme pasi që ankuesi nuk mund të zgjasë afatin strikt, të paraparë në Rregullore, duke tentuar të bëjë aplikime jo të duhura apo të keqkuptuara tek organet apo institucionet, të cilat nuk kanë autoritet apo kompetencë për gjetjen e zgjidhjes së efektshme për ankuesin lidhur me çështjen në fjalë dhe sipas Rregullores (shih, sa i përket afatit gjashtëmujor, të paraparë në nenin 35 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj): Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj), *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14881/04, vendim i datës 5 janar 2006; GjEDNj, *Svenska Flygföretagens Riksförbund dhe Skyways Express AB kundër Suedisë*, nr. 32535/02, vendim i datës 12 dhjetor 2006; GjEDNj, *Sobczynski kundër Polonisë* nr. 355/04 dhe 358/04, vendim i datës 25 shtator 2007; GjEDNj, *Hysi kundër Shqipërisë*, nr. 38349/05, vendim i datës 26 shkurt 2008).
>
> 38. Paneli thekson se PSSP-ja pranon që për qëllime të shqyrtimit të pranueshmërisë së kësaj ankese, letra e koordinatorit të UNMIK-ut për TMK-në, e datës 14 mars 2006, përmes së cilës njoftohej ankuesi se ankesa e tij nuk është pranuar dhe se lënda ishte "mbyllur", mund të konsiderohet si dita e njoftimit përfundimtar për vendimin që pretendohet të jetë marrë më 5 korrik 2005, përmes së cilit ankuesi shkarkohej nga TMK-ja.
>
> 39. Pas pranimit të këtij njoftimi, ankuesi ngriti kontest administrativ në Gjykatën Supreme kundër mosveprimit të pretenduar të KPES-it dhe TMK-së ndaj ankesës së tij kundër shkarkimit. Një peticion i tillë drejtuar Gjykatës Supreme është mjet juridik që do të mund të ofronte zgjidhje të efektshme, pasi që kontesti administrativ mund të parashtrohet në Gjykatën Supreme kundër mosmarrjes së vendimit për ankesë nga autoriteti administrativ (neni 26 i Ligjit për konteste administrative).
>
> 40. Është e vërtetë se juridiksioni i Gjykatës Supreme mund të përjashtohet me ligj (neni 30, paragrafi 1, pika 5 e Ligjit për konteste administrative). Për rastin në fjalë, Gjykata Supreme ka konstatuar se juridiksioni i saj është përjashtuar për shkak të imunitetit që gëzojnë punonjësit e UNMIK-ut dhe pjesëtarët e KFOR-it. Derisa Gjykata Supreme iu ka referuar vetëm nenit 3.2 të Rregullores së

UNMIK-ut nr. 2000/47 për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe pjesëtarëve e punonjësve të tyre në Kosovë, të datës 18 gusht 2000, nga konteksti i arsyetimit përkatës është e qartë se në fakt është bazuar në nenet 2.4 dhe 3.2 të asaj Rregulloreje, përmes të cilave garantohet imuniteti nga juridiksioni para gjykatave në Kosovë për pjesëtarët e KFOR-it *viz.* PSSP-në, zëvendësin kryesor të PSSP-së, komisionarin e policisë dhe zyrtarët e tjerë të lartë, të cilët mund t'i caktojë PSSP-ja. Mosekzistimi i juridiksionit të Gjykatës Supreme me rregull duhet të çojë në përfundim se peticioni për Gjykatën Supreme nuk është shterur në cilësinë e mjetit juridik dhe se rrjedhimisht nuk është marrë parasysh për qëllime të llogaritjes së periudhës gjashtëmujore.

41. Megjithatë, Paneli thekson se vet mungesa e juridiksionit të Gjykatës Supreme është objekti i njërës prej ankesave. Konstatimi i Panelit se Gjykata Supreme, përmes shpalljes së vetvetes si organ pa juridiksion, ka shkelur të drejtat e njerëzore të ankuesit, do të nënkuptonte se mosekzistimi i juridiksionit nuk ka qenë arsyetim kundër ankuesit për privimin e qasjes së tij në Gjykatën Supreme. Nga kjo del se gjithashtu nuk do të ishte e mundur që në këto rrethana të konsiderohet se, për qëllime të llogaritjes së afatit gjashtëmujor, kontesti administrativ i ngritur në Gjykatën Supreme ishte mjet juridik i paraparë të dështojë. Si rrjedhojë, vendimi i Gjykatës Supreme, përmes të cilit shpallej peticioni i ankuesit si i papranueshëm do të duhej të konsiderohej vendim i formës së prerë në këtë rast (krahaso GjEDNj, *Remli kundër Francës,*aktgjykim i datës 23 prill 1996, *raporte të aktgjykimeve dhe vendimeve*, 1996-II, f. 572, § 42). Ankesa e parashtruar në Panel më 2 qershor 2008, fillimisht e ngritur kundër mosveprimit të Gjykatës Supreme ndaj peticionit të tij, dhe më 17 qershor 2008, e zgjeruar edhe lidhur me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, të datës 14 maj 2008, do të duhej të konsiderohej se është parashtruar brenda periudhës gjashtëmujore. (…)"

26. Paneli konstatoi se vendimi për vërejtjen ndaj pranueshmërisë duket se varet nga rezultati i shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, kështu që ka bashkëngjitur çështjen e pranueshmërisë me atë të bazueshmërisë në pajtim me rregullën 31*bis* të Rregullores së punës së Panelit (§ 42).

27. Paneli konfirmon se çështja nëse është respektuar afati gjashtëmujor apo jo, së paku lidhur me pjesën e parë dhe të dytë të ankesës, varet nëse kontesti administrativ para Gjykatës Supreme ishte mjet juridik që ankuesi ka mundur arsyeshmërisht ta konsiderojë si të efektshëm. Është e vërtetë se ankuesi ka respektuar afatin gjashtëmujor lidhur me dy pjesët e ankesës, për aq sa pika e nisjes llogaritet nga vendimi i Gjykatës Supreme, i datës 14 maj 2008. Sa i përket pjesës së tretë të ankesës, nuk është asgjë diskutabile, pasi që është e qartë se vendimi i Gjykatës Supreme është pikënisja për ankesën, të parashtruar specifikisht kundër atij vendimi.

28. Siç është cekur në vendimin e Panelit për pranueshmëri, Gjykata Supreme shpalli peticionin e ankuesit si të papranueshëm për shkak të imunitetit nga juridiksioni, të cilin e ka KFOR-i, UNMIK-u dhe rrjedhimisht KPES-i dhe TMK-ja. Çështja që duhet të zgjidhet në këtë fazë është nëse ai vendim duhet të çojë në përfundim se mjeti juridik i ndjekur nga ankuesi nuk ishte "i duhur" (shih praktikën gjyqësore të KEDNj-

së, të cekur në vendimin e Panelit për pranueshmëri, të cituar më lartë në § 37; shih gjithashtu GjEDNj, *Pavlenko kundër Rusisë*, nr. 42371/02, aktgjykim i datës 1 prill 2010, § 74).

29. Pas shqyrtimit të mëtejmë, Paneli konsideron se kontesti administrativ i ngritur nga ankuesi nuk mund të konsiderohet si mjet jo i duhur juridik për qëllime të kushtit të shterjes së mjeteve juridike në dispozicion. Në atë kohë nuk ka mundur të thuhet se mjeti juridik nuk ka pasur mundësi të jetë i suksesshëm. Është e vërtetë se Gjykata Supreme ka ardhur në përfundim se nuk ka pasur juridiksion të shqyrtojë peticionet kundër KPES-it dhe TMK-së, por ky përfundim nuk ka rrjedhur drejtpërdrejtë nga Ligji për kontestet administrative, por më shumë ishte përfundim i bazuar në kombinimin e normave juridike. Rrjedhimisht, nuk ka qenë e mundur që arsyeshmërisht të pritet se ankuesi do ta parashihte një rezultat të tillë.

30. Paneli vjen në përfundim se fakti që ankuesi ka tentuar të gjejë zgjidhje përmes Gjykatës Supreme nuk duhet të merret kundër tij.

31. Rrjedhimisht, vërejtja e PSSP-së hidhet poshtë, dhe ankesa shpallet si e pranueshme.

32. Ky përfundim nuk paragjykon çështjen nëse vendimi i Gjykatës Supreme është në përputhje me të drejtat njerëzore të ankuesit. Kjo çështje ka të bëjë me bazueshmërinë e pjesës së tretë të ankesës, e cila do të shqyrtohet në vijim (shih §§ 62-76).

B. Bazueshmëria e ankesës

1. Drejtësia e procedurës disiplinore pranë Komisionit të përbashkët ekzekutiv për siguri

a) Parashtresat e palëve

33. Ankuesi argumenton se vendimi për shkarkimin e tij është marrë pa u kushtuar vëmendjen e duhur komenteve të tij për akuzat disiplinore që ishin ngritur kundër tij. Ankuesi beson se komentet e tij, të datës 17 shkurt 2005, Zëvendëskomandanti i TMK-së –Zona e mbrojtjes 2 në Prizren, nuk ia ka dërguar KPES.

34. PSSP-ja thekson se ai nuk është në pozicion të vendosë në mënyrë autoritative vlefshmërinë e kopjes së vendimit të PSSP-së së atëhershëm, që pohohet se është marrë më 5 korrik 2005, kopja e të cilit është dorëzuar nga ankuesi. Ajo kopje nuk ka nënshkrime, në veçanti nuk ka nënshkrim të PSSP-së, dhe ka vetëm datën e shënuar me shkrim dore (5 korrik 2005). Vendimi origjinal nuk ka mundur të gjendet në arkivat e UNMIK-ut. Në këto rrethana, PSSP-ja thekson se ai nuk është në pozicion për të komentuar mbi vlefshmërinë e vendimit për shkarkim kundër ankuesit.

b) Vlerësimi i Panelit

35. Siç u theksua më lart, Paneli mendon se ankuesi mund të konsiderohet se thirret në shkelje të së drejtës së tij për qasje në shërbimet publike, të garantuar me nenin 25 c) të KNDCP.

36. E drejta për qasje në shërbimet publike përfshin të drejtën për të mos u pushuar nga qasja në shërbimet publike në mënyrë arbitrare (Komiteti i të Drejtave të Njeriut (KDNJ), *Bandaranayake kundër Shiri Lankës*, nr. 1376/2005, mendimet e miratuara më 24 korrik 2008, § 6.4).

37. Paneli thekson se sipas nenit 5.7.4 të Kodit disiplinor të TMK-së të vitit 2001, pjesëtari i TMK-së i cili është objekt i procedurës disiplinore "njoftohet në mundësinë më të hershme të mundshme se shqyrtohet ngritja e padisë disiplinore dhe që atij i ofrohet mundësia të paraqesë deklaratë dhe dëshmi në emër të tij".

38. Ankuesi i ka paraqitur Panelit një kopje të shkresës dërguar Zëvendëskomandantit të Zonës mbrojtëse 2 të TMK-së më 17 shkurt 2005, ku përfshihen komente të detajuara të akuzave për mungesë të pajustifikueshme nga puna dhe deklaratat e paautorizuara dhënë një gazete. Ai gjithashtu ka paraqitur edhe fletëdërgimin për shkresën dërguar Zëvendëskomandantit të Zonës mbrojtëse 2 të TMK-së, të vulosur nga zyra postare më 17 shkurt 2005.

39. Paneli pranon, në bazë të elementeve që i janë paraqitur, se ankuesi vërtetë ja ka paraqitur komentet e tij për akuzat Zëvendëskomandantit të Zonës mbrojtëse 2 të TMK-së.

40. Në këto komente theksohet se ata i janë dërguar Zonës mbrojtëse 2 të TMK-së, për KPES në Shtabin e përgjithshëm të TMK-së. Paneli konsideron se ankuesi ka vepruar drejt me dërgimin e komenteve përmes zinxhirit komandues, duke filluar me Zëvendëskomandantin e zonës mbrojtëse të cilës ai i përkiste.

41. Është e paqartë se çka ndodhi me komentet e ankuesit. Në procedurën penale të ngritur nga ankuesi kundër personit i cili ishte Zëvendëskomandant i Zonës mbrojtëse 2 të TMK-së (shih vendimin e Panelit për pranueshmërinë të datës 10 qershor 2011, §§ 26-28), gjykata komunale gjeti se nuk ishte konstatuar se komentet e ankuesit ju kishin dërguar Zëvendëskomandantit personalisht (aktgjykim i 18 shtatorit 2008). Nuk është detyrë e Panelit që të deklarohet për përgjegjësinë individuale të zyrtarëve. Aq më tepër meqë Paneli e ka shpallur të papranueshme *ratione personae* pjesën e ankesës që ka të bëjë me procedurën e cekur penale (shih vendimin për pranueshmërinë të datës 9 shtator 2010, §§ 44-48).

42. Mirëpo, qëndron fakti se ishte shqiptuar sanksion disiplinor ndaj ankuesit pa ndonjë indikacion të qartë se komenteve të tij për akuzat iu kishin kushtuar vëmendje.

43. Paneli përkujton se sipas Komisionit për të drejtat e njeriut, për të siguruar qasje të barabartë në shërbimet publike, ashtu siç është garantuar me nenin 25 c) të KNDCP, jo vetëm kriteret por edhe procedura e emërimit, avancimit, suspendimit dhe e shkarkimit duhet të jenë objektive dhe të arsyeshme (KDNJ, Komenti i përgjithshëm nr. 25 (57) i datës 12 korrik 1996 për nenin 25 të KNDCP, § 23, KNDCP/C/21/Rev. 1/ Add. 7; KDNJ, *Hinostroza Solís kundër Perusë*, nr. 1016/2001, opinionet e miratuara më 27 mars 2006, § 6.2). Një procedurë nuk është objektive apo e

arsyeshme nëse nuk respekton kushtet e drejtësisë themelore të procedurës (KDNJ, *Bandaranayake kundër Shiri Lankës*, e cekur në § 36 lart, në § 7.1).

44. Paneli konsideron se e drejta e ankuesit për të mbrojtur veten në procedurën disiplinore, të garantuar në mënyrë eksplicite me nenin 5.7.4 të Kodit disiplinor të TMK-së të vitit 2001, nuk është respektuar.

45. Duke pasur parasysh rëndësinë e të drejtës për t'u mbrojtur për një person i cili është objekt i një padie disiplinore, Paneli konsideron se procedura disiplinore, që ka çuar në shkarkimin e ankuesit nga TMK-ja, nuk ka respektuar kushtet e drejtësisë themelore të procedurës. Këto procedura nuk e respektuan të drejtën themelore të ankuesit për qasje në shërbimet publike.

46. Prandaj, Paneli mendon se është shkelur neni 25 c) i KNDCP.

2. Pohimi për mosmarrjen e veprimeve lidhur me ankesën kundër vendimit disiplinor

a) Parashtresat e palëve

47. Ankuesi ankohet për faktin se ankesa e tij kundër vendimit për shkarkimin e tij në fakt nuk ishte shqyrtuar asnjëherë nga organi pranë të cilit e kishte parashtruar ankesën, përkatësisht KPES. Ai i referohet shkresës së dërguar atij më 14 mars 2006 nga koordinatori i UNMIK-ut për TMK-në, sipas së cilës ankesa e tij nuk është pranuar nga Komandanti i TMK-së dhe as nga zyrat tjera në fjalë, dhe nuk ka dëshmi se ai vërtetë ka dërguar një ankesë. Ankuesi argumenton se situata është e tillë nga fakti se Zëvendëskomandanti i TMK-së – Zona mbrojtëse 2 në Prizren, të cilit ai ia kishte dërguar ankesën më 15 korrik 2005, nuk ja kishte dërguar organit kompetent.

48. PSSP-ja thekson se, meqë ankuesi nuk ka paraqitur një kopje të vërtetuar të vendimit të PSSP-së për shkarkim, që pohohet se është marrë më 5 korrik 2005, dhe meqë vendimi origjinal nuk mund të gjendet në arkivat e UNMIK-ut, ai nuk është në gjendje të komentojë për ankesën që ka të bëjë me ankesën e ankuesit kundër shkarkimit të tij.

49. PSSP-ja gjithashtu argumenton se ankuesi, sido që të jetë, nuk ka vepruar në pajtim me procedurat e zbatuara për paraqitjen e ankesave kundër një vendimi disiplinor të formës së prerë të PSSP-së, meqë ankesën e tij ai ia paraqiti vetëm një dege të TMK-së në Prizren (Zona mbrojtëse 2 e TMK-së) dhe jo drejtpërdrejt KPES, ashtu siç kërkohet me Kodin disiplinor. Meqë UNMIK-u nuk kishte kontroll apo autoritet për Zonën mbrojtëse 2 të TMK-së, nuk mund të mbahet përgjegjës për atë se ankesa në fakt asnjëherë nuk arriti tek KPES.

b) Vlerësimi i Panelit

50. Siç u tha më lart, Paneli mendon se ankuesi mund të konsiderohet se thirret në shkelje të së drejtës së tij për mjet të efektshëm kundër pohimit për shkeljen e të drejtës së tij

për qasje në shërbimet publike (neni 2 § 3 i KNDCP, lidhur me nenin 25 c) të KNDCP).

51. Neni 2 § 3 i KNDCP kërkon që përveç mbrojtjes efektive të të drejtave të Konventës, shtetet duhet të sigurohen që individët të kenë mjete të qasshme dhe efektive për të mbrojtur me sukses këto të drejta (KDNJ, Komenti i përgjithshëm nr. 31 (80) i 29 marsit 2004 mbi natyrën e obligimit të përgjithshëm ligjor me të cilin ngarkohen shtetet që janë palë të Konventës, § 15, ICCPR/C/21/Rev. 1/ Add. 13).

52. Paneli thekson se sipas nenit 5.8.1 të Kodit disiplinor të TMK-së të vitit 2001, pjesëtarët e TMK-së mund të paraqesin ankesë kundër vendimeve për veprime disiplinore. Sipas nenit 5.8.1.2, autoriteti i apelit lidhur me vendimet e marra nga KPES në bazë të veprimeve të rëndësishmen të mospërputhjes, është KPES. Neni tjetër parasheh që "ankesa duhet të dërgohet përmes (Komandantit të TMK-së), i cili jep komente dhe kërkesën për ankesë ia dërgon KPES". Neni 5.8.2 parasheh që ankesa t'i paraqitet autoritetit të apelit "brenda 21 ditësh nga koha kur pjesëtari merr njoftim me shkrim për vendimin". Neni 5.8.7 parasheh që ankesat dhe rezultati i tyre të regjistrohen në regjistrin e disiplinës që mirëmbahet nga komandanti kompetent i grupit rajonal veprues dhe nga Komandanti i TMK-së.

53. Ankuesi i ka paraqitur Panelit një kopje të shkresës dërguar Zonës mbrojtëse 2 të TMK-së më 15 korrik 2005, ku përfshihej një ankesë kundër shkarkimit të tij. Ai paraqet edhe një deklaratë nga posta, të datës 25 janar 2006, sipas së cilës shkresa e dërguar nga ankuesi Zëvendëskomandantit të TMK-së, Zona mbrojtëse 2, është dërguar më 16 korrik 2005 (shih § 11, lart).

54. Paneli, në bazë të elementeve që i janë paraqitur, pranon se ankuesi vërtetë i ka dërguar një ankesë Zëvendëskomandantit të TMK-së, Zona mbrojtëse 2. Paneli konsideron se nuk ka nevojë të kontrollohet nëse në KPES po ashtu ka arritur një padi apo ankesë, që pohohet se i është dërguar "Komisionit të përbashkët implementues – KPES", në shtabin e KFOR-it, më 18 korrik 2005 (shih § 12, lart).

55. Në këtë ankesë të datës 15 korrik 2005 thuhet se kjo i është dërguar Zonës mbrojtëse 2 të TMK-së, për shtabin e përgjithshëm të TMK-së dhe për KPES. Paneli konsideron se ankuesi ka vepruar drejt me dërgimin e ankesës së tij përmes zinxhirit komandues, duke filluar me Zëvendëskomandantin e zonës mbrojtëse të cilës ai i përkiste.

56. Nuk është e qartë se çka ndodhi me ankesën e ankuesit. Në procedurën e lartcekur penale të ngritur nga ankuesi kundër personit i cili ishte Zëvendëskomandant i TMK-së, Zona mbrojtëse 2 (shih § 41, lart), gjykata komunale e Prizrenit gjeti se nuk ishte konstatuar se ankesa e ankuesit iu ishte dërguar Zëvendëskomandantit personalisht (aktgjykim i 18 shtatorit 2008). Siç u tha më lart, nuk është detyrë e Panelit të shprehet për përgjegjësitë individuale të zyrtarëve. Aq më tepër meqë Paneli e shpalli të papranueshme *ratione personae* pjesën e ankesës lidhur me procedurën e cekur penale (shih § 41, ;art).

57. Mirëpo, qëndron fakti se koordinatori i UNMIK-ut për TMK, më 14 mars 2006, theksoi se ankesa e ankuesit asnjëherë nuk ishte shqyrtuar nga KPES, meqë KPES asnjëherë nuk kishte marrë ndonjë ankesë (shih § 13, lart).

58. Paneli konsideron se e drejta e ankuesit për të parashtruar ankesë kundër shkarkimit të tij, të garantuar në mënyrë eksplicite me nenin 5.8.1 të Kodit të disiplinës të TMK-së të vitit 2001, nuk është respektuar.

59. Efekti i 2 § 3 i KNDCP është të kërkojë sigurimin e një mjeti që të merret me thelbin e një ankese të diskutueshme sipas Konventës dhe të ofrojë ndihmën adekuate (shih, sa i përket dispozitës korresponduese të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) (Grand Chamber), *Kudła kundër Polonisë*, nr. 30210/96, aktgjykim i 26 tetorit 2000, § 157, *KEDNJ*, 2000-XI). Derisa efekti i një mjeti në kuptim të nenit 2 § 3 të KNDCP nuk varet nga sigurimi i një rezultati të favorshëm për ankuesin, e drejta për mjet të efektshëm garanton së paku që ankesa lidhur me pohimin për shkeljen e të drejtave të njeriut të ankuesit të shqyrtohet dhe të merret një vendim.

60. Në këtë rast, e drejta për ankesë kundër shkarkimit ishte hapur në aspektin teorik, dhe ankuesi e ka shfrytëzuar këtë të drejtë, por ankesa e tij nuk rezultoi me një shqyrtim të sërishëm të akuzave kundër tij. Duke pasur parasysh faktin se gjatë procedurës disiplinore ankuesi nuk ka pasur mundësi të paraqesë pikëpamjet e tij për akuzat (shih § 42, lart), Paneli konsideron se mosndërmarrja e veprimeve për ankesën e tij rezultoi me dështimin për respektimin e të drejtës së tij themelore për mjet të efektshëm për shkeljen e të drejtës së tij që të mos shkarkohet në mënyrë arbitrare nga shërbimet publike.

61. Prandaj, Paneli mendon se është shkelur neni 2 § 3 i KNDCP, lidhur me nenin 25 c) të KNDCP.

3. Mosshqyrtimi i kontestit administrativ të ngritur nga ankuesi nga Gjykata Supreme

a) Parashtresat e palëve

62. Ankuesi ankohet për aktgjykimin e Gjykatës Supreme të datës 14 maj 2008 me të cilin shpalli të papranueshëm kontestin administrativ të parashtruar nga ai, që kishte të bënte me dështimin e KPES dhe të KNDCP që të ndërmarrin veprime për ankesën e tij kundër vendimit për shkarkim.

63. PSSP-ja argumenton se ankuesi gjatë gjithë kohës ka pasur qasje në mjetet juridike që janë siguruar në fazat e ndryshme të procedurës. Ai në fakt ka shfrytëzuar mjetet administrative dhe juridike, dhe atij nuk i është mohuar qasja në to. Në veçanti sa i përket kontestit administrativ të ngritur pranë Gjykatës Supreme, PSSP-ja thekson se Gjykata e shpalli peticionin e ankuesit të papranueshëm sepse nuk mund të ngrihej kontest administrative kundër KPES brenda KFOR-it apo kundër Zonës mbrojtëse 2 të TMK-së. Nuk është në kompetencë të Panelit të veprojë si “gjykatë apeli” mbi Gjykatën Supreme. Sipas PSSP-së, Gjykata Supreme i ka shqyrtuar parashtresat e

paraqitura nga palët, dhe vetë fakti se pala që i është nënshtruar procedurës gjyqësore është e pakënaqur me rezultatin e procedurës së tillë, nuk mund vetvetiu të ngrit një çështje lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë dhe për mjet të efektshëm.

b) Vlerësimi i Panelit

64. Siç u tha më lart, Paneli mendon se ankuesi mund të konsiderohet se thirret në shkelje të së drejtës së tij për mjet të efektshëm kundër pohimit për shkeljen e së drejtës për qasje në shërbimet publike (neni 2 § 3 i KNDCP, lidhur me nenin 25 c) të KNDCP.

65. Ankuesi pati qasje në Gjykatën Supreme vetëm sa për t'i treguar se ankesa e tij ishte e papranueshme për shkak të imunitetit që KPES dhe TMK-ja e gëzonin nga gjykatat (shih § 17, lart). Për aq sa është konstatuar deri këtu, ai pra pati qasje në një mjet që ekzistonte brenda sistemit gjyqësor të Kosovës.

66. Mirëpo, kjo vetvetiu nuk shteron domosdoshmërish kushtet e nenit 2 § 3 të KNDCP. Sërish duhet konstatuar nëse shkalla e qasjes që është ofruar sipas rregulloreve përkatëse ishte e mjaftueshme për të siguruar të drejtën e ankuesit për mjet të efektshëm (krahaso GJEDNJ, *Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykim i 28 majit 1985, *Publikime të gjykatës*, Seria A, vëllimi 93, §§ 56-57).

67. Paneli përkujton se e drejta për qasje në gjykatat, aty ku zbatohet, nuk është absolute por mund t'i nënshtrohet kufizimeve; këto janë të nënkuptuara meqë e drejta për qasje "nga vetë natyra kërkon të rregullohet nga shteti, një rregullim që mund të ndryshojë në kohë dhe varësisht nga vendi sipas nevojave dhe resurseve të komunitetit si dhe nga individët". Megjithatë, këto kufizime të zbatuara nuk duhet të ulin apo të pakësojnë qasjen që i është lënë në dispozicion individit në mënyrën e tillë apo deri në atë shkallë ashtu që të dëmtohet vetë thelbi i të drejtës. Veç kësaj, "kufizimi nuk do të jetë kompatibil me (teksti përkatës i marrëveshjes, siç është neni 6 § 1 i KEDNJ) nëse nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit në mes të mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet" (GJEDNJ, *Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të cekur lart, në § 57).

68. Paneli konsideron se arsyetimi i njëjtë mund të vlejë edhe për të drejtën për mjet të efektshëm, të garantuar me nenin 2 § 3 të KNDCP.

69. Lidhur me imunitetin nga juridiksioni i gjykatave të Kosovës, që u është dhënë KPES dhe TMK-së, Paneli konsideron se ky imunitet është i natyrës *sui generis*. Në njërën anë, ky imunitet është pjesë e imunitetit që u është dhënë Kombeve të Bashkuara si organizatë ndërkombëtare. Në anën tjetër, është imunitet që u është dhënë organeve që veprojnë vetëm në kontekstin e Kosovës dhe që kryejnë funksione që zakonisht do të ekzekutoheshin nga autoritetet nacionale. Megjithatë, Paneli konsideron se pranimi i imunitetit duhet të konsiderohet nga pikëvështrimi i UNMIK-ut si organ subsidiar i Kombeve të Bashkuara, që është si pjesë e imunitetit që përgjithësisht u është dhënë Kombeve të Bashkuara, në pajtim me nenin 105 të Kartës së Kombeve të Bashkuara të 24 tetorit 1945.

70. Sa i përket imunitetit të organizatave ndërkombëtare, Paneli përkujton se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konsideron se "kur shtetet krijojnë organizata ndërkombëtare në mënyrë që të vazhdojnë apo përforcojnë bashkëpunimin e tyre në fusha të caktuara të aktiviteteve, dhe kur këta organizata i veshin me kompetenca të caktuara dhe atyre u japin imunitet, mund të ketë implikime sa i përket mbrojtjes së të drejtave fundamentale" (GJEDNJ (Grand Chamber), *Waite dhe Kennedy kundër Gjermanisë*, nr. 26083/94, aktgjykim i 18 shkurtit 1999, § 67, *KEDNJ*, 1999-I; GJEDNJ (Grand Chamber), *Beer dhe Regan kundër Gjermanisë*, nr. 28934/95, aktgjykim i 18 shkurtit 1999, § 57; GJEDNJ (Grand Chamber), *Princi Hans-Adam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë*, nr. 42527/98, aktgjykim i 12 korrikut 2001, § 48, KEDNJ, 2001-VIII).

71. Qëndron fakti se Gjykata ka konstatuar se "do të ishte e papajtueshme me objektin dhe qëllimin e (KEDNJ), nëse shtetet kontraktuese në këtë mënyrë do të liroheshin nga përgjegjësia e tyre sipas (KEDNJ) lidhur me fushën e aktivitetit që mbulohet nga një pushtet i tillë. Gjatë marrjes së vendimit nëse veshja e një organizate ndërkombëtare me imunitet nga juridiksioni nacional është e lejueshme sipas (KEDNJ), një faktor i rëndësishëm është nëse ka pasur në dispozicion mjete alternative të arsyeshme për të mbrojtur në mënyrë të efektshme të drejtat sipas (KEDNJ)" (GJEDNJ (Grand Chamber), *Princi Hans-Adam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë*, § 48; në kuptimin e njëjtë, GJEDNJ (Grand Chamber), *Waite dhe Kennedy kundër Gjermanisë*, § 68; GJEDNJ (Grand Chamber), *Beer dhe Regan kundër Gjermanisë* § 58).

72. Mirëpo, Paneli thekson se Gjykata Evropiane i jep një rëndësi të veçantë rolit të Kombeve të Bashkuara sa i përket ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, veçanërisht sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Në një rast që kishte të bënte me veprimet dhe mosveprimet e shteteve që janë palë e KEDNJ, të ndërmarra në emër të Kombeve të Bashkuara në fushat ku UNMIK-u dhe KFOR-i ishin përgjegjës, Gjykata ka konstatuar se "(KEDNJ) nuk mund të interpretohet në mënyrën e tillë që t'u nënshtrohet veprimeve dhe mosveprimeve të palëve kontraktuese të cilat janë të mbuluara me rezolutat e (Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara) dhe që paraqiten para apo gjatë misioneve të tilla, për shqyrtim nga Gjykata. Po të ndodhte kjo do të ishte ndërhyrje në përmbushjen e misionit kyç të KB-së në këtë fushë duke përfshirë (…) zbatimin efektiv të operacioneve të saj. Do të ishte faktikisht e njëjtë sikurse të shqiptoheshin kushtet për implementimin e rezolutave të (Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara) të cilat nuk janë paraparë në vetë tekstin e rezolutës" (GJEDNJ (Grand Chamber), *Behrami dhe Behrami kundër Francës*, nr. 71412/01, dhe *Saramati kundër Francës, Gjermania dhe Norvegjia*, nr. 78166/01, vendim i 2 majit 2007, § 149; shih gjithashtu § 151 të këtij vendimi, ku gjykata u referohet Kombeve të Bashkuara si "organizatë me juridiksion universal që përmbush objektivin e saj kolektiv imperativ të sigurisë").

73. Paneli konkludon, sikurse Gjykata Supreme e Holandës në një rast që kishte të bënte me pohimin për përgjegjësinë e Kombeve të Bashkuara për ngjarjet që ndodhën në Srebrenicë në vitin 1995, se Kombet e Bashkuara "zënë një vend të veçantë në komunitetin ligjor ndërkombëtar", dhe se duke marrë parasysh misionet e tyre sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, imuniteti që u është dhënë "është

absolut", dhe se respektimi i këtij imuniteti është obligim që "(mbizotëron) mbi obligimet kontradiktore nga ndonjë marrëveshje tjetër ndërkombëtare" (*Hoge Raad* (Gjykata Supreme), 13 prill 2012, *Stichting "Nënat e Srebrenicës" dhe të Tjerët kundër shtetit të Holandës dhe Kombeve të Bashkuara*, §§ 4.3.4 dhe 4.3.6).[1]

74. Duke u kthyer në veçanti tek faktet e rastit aktual, Paneli thekson se imuniteti që i është dhënë UNMIK-ut dhe KFOR-it ka të bëjë me veprimet apo mosveprimet që i atribuohen KPES dhe TMK-së. Këto janë dy organe që drejtpërsëdrejti merren me çështjet e sigurisë për të cilën gjë u krijuan UNMIK-u dhe KFOR-i. Prandaj nuk ka hapësirë për ndonjë shmangie të mundshme nga parimet që lidhen me imunitetin e Kombeve të Bashkuara në çështjet e sigurisë, të cekura lart.

75. Duke marrë parasysh pozitën e veçantë të UNMIK-ut dhe KFOR-it, Paneli konstaton se duke zbatuar imunitetin e KPES dhe TMK-së nga juridiksioni i gjykatave të Kosovës, Gjykata Supreme nuk ka bërë veprime që kanë shkelur të drejtën e ankuesit për mjet të efektshëm.

76. Prandaj, Paneli është i mendimit se neni 2 § 3 i KNDCP, lidhur me nenin 25 c) të KNDCP nuk është shkelur.

V. REKOMANDIMI

77. Në parashtresat e tij për bazueshmërinë, ankuesi kërkon kompensim që korrespondon me të drejtat e personit në rangun e majorit në TMK, *d.m.th.* pagë deri më 14 mars 2006 dhe pension pleqërie që nga kjo datë.

78. Duke pasur parasysh llojin e shkeljes së nenit 2 § 3 dhe 25 c) të KNDCP, Paneli nuk mund të spekulojë nëse rezultati i procedurës do të ishte ndryshe po të mos kishte ndodhur një shkelje e tillë. Prandaj, nuk rekomandon ndonjë shpërblim për dëme monetare.

79. Megjithatë, sipas mendimit të Panelit, qëndron fakti se procedura disiplinore kundër ankuesit nuk u zbatua plotësisht në pajtim me KNDCP. Kjo rezultoi me një shkallë të konsiderueshme tensioni për ankuesin. Paneli konsideron se UNMIK-u duhet të ndërmarrë hapat e duhur për kompensimin adekuat të ankuesit për dëmet jomonetare që ai i ka pësuar.

PËR KËTO ARSYE**,**

Panel unanimisht,

---

[1] Aktgjykimi gjendet në *http://www.rechtspraak.nl/Organisatie/Hoge-Raad/Supreme-court/Summaries-of-some-important-rulings-of-the-Supreme-*Court/*Pages/Ruling-Dutch-Supreme-Court-Mothers-of-Srebrenica.aspx*.

1. **E REFUZON KUNDËRSHTIMIN PËR PRANUESHMËRINË E ANKESËS, DHE E SHPALL PJESËN TJETËR TË ANKESËS TË PRANUESHME;**

2. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE T**Ë NENIT **25 c) TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE;**

3. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 2 § 3 TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE SA I PËRKET MOSNDËRMARRJES SË VEPRIMEVE LIDHUR ME ANKESËN E ANKUESIT KUNDËR SHKARKIMIT TË TIJ;**

4. **KONSTATON SE NUK KA PASUR SHKELJE TË NENIT 2 § 3 TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE LIDHUR ME REFUZIMIN E KONTESTIT ADMINISTRATIV TË NGRITUR NGA ANKUESI;**

5. **REKOMANDON QË UNMIK-U:**

a. TË NDËRMARRË HAPAT E DUHUR PËR KOMPENSIMIN ADEKUAT TË ANKUESIT PËR DËMET JOMONETARE;

b. TË NDËRMARRË MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT DHE TË INFORMOJË ANKUESIN DHE PANELIN PËR ZHVILLIMET E MËTEJSHME NË KËTË RAST.